



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 111-Shtator 2012 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



Pamje nga objekti i ri i shkollës “Hilmi Hoti” në Carrallukë



Përmbajtja

Nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve.....	3
Një grup shokësh zviceran, ndihmojnë 53 familje skamnore me pako ushqimore.....	5
Kilaj uron qytetarët e Malishevës me rastin e përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë	5
Kryetari priti palët.....	6
Nga mbledhja e Komiteti për Politikë dhe Financa.....	7
U përrua objekti SHMU “Hilmi Hoti” në Carrallukë	7
KK miratoi buxhetin komunal për vitin 2013	10
Shënohet Dita e Rinisë në Malishevë.....	11

Nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve

U urua për një fillim të mbarë dhe me suksese të shtuara;

Sot fillojnë punimet për ndërtimin e trotuarit 850 m, nga QKMF deri te rruga e Qendrës së Kompetencës;

Gjatë muajit korrik e gusht, 240 intervenime në shuarjen e zjarrit fushor e malor, situata nën kontroll;

Gjendja në shëndetësi stabile

Malishevë, 3 shtator



Në mbledhjen e sotme të Bordit të Drejtorëve, e cila është mbajtur në objektin e ri, në të cilin tashmë janë vendosur një pjesë e stafit të komunës, bashkë me kryetarin Isni Kilaj, janë diskutuar dhe janë raportuar një varg çështjesh nga drejtorët e drejtorive komunale.

U urua për një fillim të mbarë dhe me suksese të shtuara

Fillimisht kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka uruar për fillimin e procesit

mësimor duke dëshiruar sukses të shtuar në këtë aspekt. “Sot është fillimi i procesit mësimor dhe unë do të uroja drejtorin e Drejtorisë Komunale për Arsim, nxënësit dhe arsimtarët e Komunës tonë, për një fillim të mbarë dhe me suksese të shtuara”, kështu tha midis tjerash kryetari Kilaj, duke bërë të ditur poashtu se tashmë janë në proces të përfundimit, respektivisht në ndërtim e sipër tri shkolla në këtë komunë, si ajo në Banjë, Carrallukë dhe Vërmicë. Kryetari Kilaj la të kuptohet se në këtë drejtim është bërë bukur shumë, por poashtu ka ende për tu bërë, sidomos në disa fshatra të cilat kanë nevojë për ndërtim apo renovim shkollash, e që sipas tij, këto janë prioritet në planin e tij, sa i përket rregullimit të



infrastrukturës në lëmin e arsimit. Z. Kilaj si raste prioritare përmendi, shkollat në Shkozë, Damanek, Bubavec e Bellanicë.

Në këtë aspekt, drejtori i arsimit, z. Isuf Morina, bëri të ditur se në të gjitha shkollat e komunës, ka filluar procesi mësimor. “Në të gjitha shkollat sot ka fillur procesi i rregullt mësimor, dhe të gjitha janë të pajisura me dokumentacionin fillestar, në përjashtim të abetares unike, e cila pritet të na vije”, tha ndër të tjera drejtori Morina, i cili poashtu uroj për një mbarëvajtje mësimore.

Sot fillojnë punimet për ndërtimin e trotuarit

Në këtë mbledhje, u bë e ditur edhe për fillimin e trotuarit përgjatë rrugës kryesore nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare-QKMF, deri të rruga e Qendrës së Kompetencës. Drejtori i Urbanizimit, z. Esat Paçarizi tha se “që nga sot do të fillojnë punimet për ndërtimin e trotuarit, projekt i komunës i fituar Komisioni European, dhe i cili do të implementohet nga IOM-i. “Ky trotuar me gjatësi prej 850 m dhe me gjerësi prej 2 m, do të jetë i përcjellur edhe me ndriçim anash dhe do të mbillen drunj gjelbërues përkaj tij”, theksoj drejtori Paçarizi. I tërë projekti ka një shumë prej 143 mijë euro, ndërsa pjesëmarrja e komunës në këtë projekt është 10%.



Gjatë muajit korrik e gusht, 240 intervenime në shuarjen e zjarrit, situata nën kontroll

Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z. Halit Zogaj, ka raportuar se “gjatë muajit korrik e gusht në komunën e Malishevës, kanë qenë 240 intervenime në shuarjen e zjarreve, kryesisht fushore dhe malore, por situata çdo herë ka qenë nën kontroll”. Sipas z. Zogaj Shërbimi i Zjarrfikësve i kësaj komune, në muajin gusht, ka ndihmuar edhe Komunën e Dragashit për gjashtë ditë tërë në shuarjen e zjarrit, i cili kishte kapluar malet e kësaj komune.

Gjendja në shëndetësi stabile

Ndërsa sa i përket sektorit të shëndetësisë, drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë, z. Skënder Hoti ka bërë të ditur, se sa u përket raporteve nga QKMF ajo është stabile.

Një grup shokësh zviceran, ndihmojnë 53 familje skamnore me pako ushqimore

Malishevë, 6 shtator

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur në takim zviceranin, Jean Michel Delacretaz, i cili në emër të një grupi shokësh nga Kantoni Valais i Zvicres, ka sjellë pako ushqimore për 53 familje të komunës së Malishevës.



“Këto pako do të shpërndahen përmes shoqatave që operojnë në komunën e Malishevës, dhe ato për familje të varfra” ka bërë të ditur zvicerani Delacretaz.

Përveç kësaj, me 300 euro është ndihmuar edhe një familje skamnore nga Drenovci i Malishevës.

Kryetari Kilaj, ka falënderuar z. Delacretaz, për vullnetin e treguar për të ndihmuar qytetarët me gjendje të rëndë sociale në Malishevë.

Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Kilaj uron qytetarët e Malishevës me rastin e përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë

Malishevë, 10 gusht

Kryetari i Malishevës, z. Isni Kilaj, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, i ka uruar qytetarët e Komunës që ai udhëheq, me rastin e përfundimit të Mbikëqyrjes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës. “Uroj të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës. Ky është edhe një hap më shumë përpara në ndërtimit të shtetit të Kosovës”, tha Kilaj.

“Pavarësisht të arriturve të deritanishme, ne nuk jemi të kënaqur dhe synojmë të punojmë edhe më shumë, duke realizuar projekte të tjera për krijimin e mirëqenies më të mirë për të gjithë qytetarët”, tha



mes tjerash, kryetari Kilaj, në urimin e tij me rastin e përfundimit të Mbikëqyrjes së Pavarësisë së Kosovës.

Në këtë mbledhje të Këshillit të Drejtorëve, kryetari prezantoi edhe projektet e realizuara dhe në realizim e sipër të vitit 2012, siç janë shkollat moderne në Carrallukë, në Banjë dhe ajo në Vërmicë, vazhdimi i ndërtimit të stadiumit të qytetit, pastaj trotuare dhe rrugë të asfaltuara në lagje, siç janë ato në Kijevë e Bubavec, ujësjellës dhe dymbëdhjetë projekte të kanalizimeve nëpër fshatra (Plloqicë, Drenovc, Senik, Bubavec, Astrazup, Maxharrë, Lladrovç, Shkarashnik, Gajrak, Lagja Mirditë e Malishevës, Bellanicë dhe Ngucat), por edhe në kolektorin e përgjithshëm-faza e tretë (nga Temeçina në Bubël). Të gjitha këto projekte janë realizuar apo janë duke u realizuar me mjete të komunës, ndërsa dy projekte janë në bashkëfinancim me IOM-in (trotuari nga QKMF-së deri te rruga e Qendrës së Kompetencës), dhe me USAID-in (zgjerimi i kapaciteteve të ujësjellësit të Banjës). “Po ashtu kemi ndihmuar edhe fermerët e komunës sonë, përderisa edhe ndërtimi i autostradës ka efektin e saj pozitiv”, tha Kilaj. Njëkohësisht u potencua edhe ndërtimi i Muzeut të Qytetit, i cili tashmë ka filluar.

Drejtori për Buxhet dhe Financa, z.Vesel Krasniqi, paraqiti para drejtorëve, draft buxhetin komunal për vitin 2013, ku në bazë të kufijve buxhetor të përcaktuar nga Ministria për Ekonomi dhe Financa (MEF), buxheti i Komunës së Malishevës, do të jetë 10.2 milion euro.

Kryetari priti palët

Malishevë, 13 shtator

Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, si çdo të enjte edhe sot, për dy orë të tëra ka pritur qytetarët në zyrën e tij, duke u njoftuar me problemet dhe shqetësimet e tyre, por edhe duke marrë falënderime për ndihmën dhe kujdesin e tij dhe të komunës, për mirëqenien e qytetarëve.

Problemet socio-ekonomike, ishin ato të cilat kryesisht i paraqitshin palët, para kryetarit, përderisa, z. Kilaj, ju ka ofruar atyre përkrahje, këshilla dhe udhëzime për adresimin e problemeve e tyre.

Në mesin e qytetarëve të shumtë, që kryetari ka pritur në zyrën e tij, kishte edhe prej atyre, që shprehnin falënderimet e tyre, për përkrahjen e kryetarit dhe të komunës, siç janë ndihmat në ndërtimin e shtëpive dhe ndihma për rastet e rënda sociale.



Nga mbledhja e Komiteti për Politikë dhe Financa

Malishevë, 17 shtator

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), në mbledhjen e mbajtur sot, të drejtuar nga kryesuesi i KK të Malishevës, z.Ragip Begaj, ka dhënë katër rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, në mesin e tyre edhe draft buxhetin për vitin 2013.

Pas miratimit të rendit të ditës dhe procesverbalit nga mbledhja e kaluar, KPF, ka rekomanduar për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale, draft buxhetin për vitin 2013, pasi paraprakisht, në këtë mbledhje, drejtori për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, ka dhënë sqarimet e për buxhetin e vitit të ardhshëm. Drejtori Krasniqi, po ashtu ka dhënë sqarimet e nevojshme, edhe për projekt rregulloren për tatimin mbi pronën e paluajtshme.

Për mbledhjen e ardhshme, është rekomanduar për shqyrtim edhe projekt rregullorja për organizimin e brendshëm të Administratës Komunale, për të cilën sqarimet para anëtarëve të KPF-së, i ka dhënë këshilltari për çështje juridike i Kryetarit të Komunës, z.Muharrem Morina.

Edhe raporti i punës së kompanisë së “Hidroregionit”, njësia në Malishevë, është rekomanduar për mbledhjen e Asamblesë Komunale.

U përrua objekti SHMU “Hilmi Hoti” në Carrallukë

Malishevë, 18 shtator

Sot në fshatin Carrallukë, është bërë përrimi i objektit të SHMU “Hilmi Hoti”. Në ceremoninë e përrimit, përveç banorëve të shumtë, morën pjesë edhe Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, me bashkëpunëtor dhe Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z.Ramë Buja.





Duke marrë fjalën në këtë përurim, Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, tha se: “Jam i privilegjuar dhe i emocionuar, që sot po bëjmë përurimin e një shkolle të tillë, e cila jo vetëm që ia shton bukurinë, por ia shton i shton vlerë fshatit dhe Malishevës në përgjithësi. Ky objekt është mesin e shkolla të mira në Malishevë. Unë dua t’ju tregoj edhe njëherë se Malisheva që nga paslufta, ka ndërtuar dhjetëra shkolla, pasi që nga viti i largët 1975, nuk është ndërtuar asnjë shkollë në territorin e sajë”. Kryetari Kilaj, më pas i përmendi me rend të gjitha shkollat e ndërtuara pas luftës, duke e vlerësuar fushën e arsimit, si fushën në të cilën është investuar më së shumti dhe ka qenë prioritet i të gjitha qeverive që kanë qenë në Malishevë. “Meritë për për të gjitha këto ndërtime është liria, të cilën e gëzojmë sot, e meritë për këtë janë dëshmorët, dhe pikërisht kjo shkollë, me krenari mban emrin e njërit nga dëshmorët e Komunës së Malishevës dhe ish nxënësit të sajë, Hilmi Hysni Hoti. Përgëzoj dhe uroi edhe familjen dhe ju siguroj që brenda pak ditësh, do ta kemi edhe bustin e dëshmorit në oborrin e shkollës suaj”, tha kryetari Kilaj.



Ndërsa ministri i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, z.Ramë Buja, në fjalën e tij, pasi i uroi të gjithë për shkollën e re, tha se “të hapësh një shkollë, është sikur të hapësh një derë drejt botës së civilizuar. Edhe Qeveria e Kosovës, prioritet e ka investimin në arsim dhe kjo do të vazhdojë edhe në vitet



e ardhshme. Tani ju do të punoni në një ndërrim dhe kjo është mrekullia, sepse është edhe qëllimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës”. Në fund, ministri Buja, sugjeroi të gjithë për ruajtjen e kësaj shkollë.

Duke marrë fjalën, drejtori i SHMU “Hilmi Hoti”, z. Jup Hoti, tha: “Sot e përurojmë objektin e shkollës sonë, e cila këtë vit kremton 85 vjetorin e punës. Shkolla jonë, është ndër të parat në Malishevë dhe daton që nga viti 1928. Këtu vijuan mësimin fëmijët nga e gjithë kjo trevë përreth fshatit Carrallukë” tha në fjalimin e tij, drejtori i SHMU “Hilmi Hoti”, z. Jup Hoti. Ai më pas përmendi edhe arsimtarët e njohur shqiptar, që kanë dhënë mësim në këtë shkollë dhe që kanë dalë nga kjo shkollë, e më pas prezantoi një historik të shkurt të shkollës. SHMU “Hilmi Hoti”, ka rreth 500 nxënës, e pajisur me dhoma mësimi, salla dhe kabinete për zhvillimin e mësimet. Drejtori Hoti, falënderoi Komunën e Malishevës, për investimin në ndërtimin e kësaj shkolle, si dhe MASHTK-ën për sigurimin e inventarit për këtë shkollë.

Objekti i SHMU “Hilmi Hoti” në Carrallukë, ka një hapësirë prej 1200 metra katror, ndërsa ndërtimi i saj ka kushtuar 457 mijë euro, investim i Komunës së Malishevës, ndërsa punimet janë kryer nga kompania “Arbëri NS”. Inventari i shkollës, është siguruar nga Ministria e Arsimit.





KK miratoi buxhetin komunal për vitin 2013

Malishevë, 27 shtator



Asambleja Komunale e Malishevës, ka mbajtur sot mbledhjen e tridhjetenjtë të radhës, ku me shumicë votash, është miratuar buxheti komunal për vitin 2013, si dhe janë miratuar edhe dy rregullore. Në këtë mbledhje ka marrë pjesë edhe Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, i cili është përgjigjur në pyetjet e këshilltarëve, për çështje të ndryshme, përfshi edhe buxhetin për vitin e ardhshëm.

Projekt buxhetin për vitin 2013, para këshilltarëve e ka prezantuar drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z.Vesel Krasniqi, i cili po ashtu është përgjigjur

në interesimin e këshilltarëve për çështje të caktuar buxhetore, varësisht prej interesimit të tyre. Këshilltarët, me shumicë votash kanë miratuar buxhetin për vitin e ardhshëm, cili do të jetë 10.2 milion euro.

Në këtë mbledhje, me shumicë votash janë miratuar edhe rregulloret për tatimin mbi pronën e paluajtshme dhe rregullorja për organizimin e brendshëm të administratës komunale.

Në pikën e pestë të rendit të ditës, para këshilltarëve komunale, është paraqitur një raport i punës së njësisë së “Hidroregjionit Jugor” në Malishevë, ndërsa këshilltarët komunal kanë dhënë vërejtje për punën në menaxhimin e ujësjellësve, furnizimin me ujë, investimet e kompanisë së “Hidroregjionit Jugor”, si dhe për mos menaxhim të sistemeve të kanalizimeve, përderisa qytetarët paguajnë taksë për to.

Në fund të mbledhjes së sotme, në bashkëpunim me OSBE-në, në mënyrë simbolike është shënuar edhe “Dita Ndërkombëtare e Demokracisë”, në të cilën kanë asistuar nxënës të shkollave të mesme të Malishevës, të cilët kanë parashtruar edhe pyetje në drejtim të këshilltarëve komunal dhe kryesuesit të Asamblesë, z.Ragip Begaj.

Shënohet Dita e Rinisë në Malishevë

Malishevë, 28 shtator



Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport e Komunës së Malishevës, në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën Rinore dhe Këshillin e Veprimit Rinor Lokal (KVRL), përmes aktiviteteve të ndryshme, po shënojnë Ditën e Rinisë, në Malishevë.

Dita e Rinisë në Malishevë, shënohet çdo 28 shtator, në kuadër të shënimit të Muajit të Rinisë në Kosovë.

Me këtë rast, në Malishevë janë organizuar, këto aktivitete:

- Përrurimi i librit me poezi “Kënga ime”, e autorit Musa Kastrati;
- Marshi për ruajtjen e ambientit, me ç’rast janë mbjellë drunj në lokacione të ndryshme në qytetin e Malishevës;
- Loja e “kërkimit të thesarit”;
- Debat “Karl Popper”, me temën: Rinia dhe Ambienti.

Aktivitetet do të përmbyllen me një koncert në parkun e qytetit, ku do të marrin pjesë grupe dhe këngëtar nga Malisheva.

Përgatitur nga Zyra për Informim Publik- Malishevë